

V E N D I M
Nr. 302, datë 27.6.2002

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.31, DATË 20.1.2001 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.31, datë 20.1.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhet ky ndryshim:

1. Paragrafi i parë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Masa e pagesës për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë është 6 000 lekë në muaj dhe indeksitet me rritjen e pagës minimale në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat e tjera që invalidi paraplegjik dhe tetraplegjik përfiton nga shteti. Të njëjtën pagesë përfiton edhe kujdestari i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të vendimit."

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i vitit 2002 për pagesën e paafëtisë, miratuar për Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko